Kronikë

Kaluara e errët/ U vra sot në Tiranë në një atentat me eksploziv, 27-vjeçari i akuzuar për vrasje edhe në Greqi

11 Qershor, 2022 20:58

Madhësia e tekstit:

Ndonëse i ri në moshë, pas 27 viteve të Aleksandër Sadikaj, i cili mbeti i vrarë sot në Tiranë në një atentat me eksploziv fshihen ngjarje të rënda dhe krime kundër jetës.

I skeduar në policinë shqiptare dhe i akuzuar për disa krime, por duket se e kaluara e errët e tij nuk është shkruar vetëm brenda kufijve të Shqipërisë.

Gazetari Igli Çelmeta raportoi për "BalkanWeb" se Sadikaj është i akuzuar për vrasje në vendin fqinj në Greqi. 27-vjeçari akuzohet për një krim të ndodhur 6 vite me parë në Athinë dhe dyshohet se vrasja është kryer nga Sadikaj për prishje të pazareve të drogës.

Ngjarja e rëndë ndodhi sot rreth orës 13:30 pranë TEG-ut, ku makina me të cilën lëvizte 27-vjeçari shpërtheu me eksploziv.
Burime për News24 bëjnë me dije se autorët e kanë telekomanduar shpërthimin me eksploziv nga një distancë e afërt me vendin e ngjarjes 27-vjeçari i vrarë ne atentat Aleksandër Sadikaj, ishte njeri i afërt i shtetasit Q.R., i cili vite më parë ka kryer vrasje në Gjirokastër.

Po ashtu Sadikaj është njeri i afërt me të fortin e Memaliajt, me inicialet A.K., i cili është nën akuzë nga belgët për vrasjen e dy vëllezërve Çaça, të ekzekutuar në 13 prill të viti 2001 në Belgjikë.

Sipas policisë, 27-vjeçari ishte person me precedent të theksuar kriminal, në fushën e vjedhjes, krimeve ndaj personit dhe narkotikëve, por aktualisht nuk ishte në kërkim.

- Më 09.04.2011 është arrestuar në Berat, pasi, së bashku me një person tjetër kanë tentuar të vjedhin në subjektin AlbTelecom-Berat;

- Më 30.04.2011 është shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Vlorë, pasi Gjykata e Vlorës i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Vjedhja", kryer në bashkëpunim;

- Më 31.05.2017 është shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Nr.2 Tiranë, pasi Gjykata e Tiranës i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik". Më 23.08.2018, Gjykata e Tiranës e ka dënuar me 8 muaj burgim, për këtë vepër;

- Më 29.05.2017 është shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Nr.2 Tiranë për veprat penale "Goditje për shkak të detyrës", "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik" dhe "Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik";

- Më 09.07.2019 është shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Sarandë, pasi në bashkëpunim me një shtetas tjetër, gjatë një konflikti për motive të dobëta, kanë plagosur me thikë shtetasin A. D., duke i shkaktuar dëmtime serioze në trup. Më datë 30.07.2019, për këtë ngjarje, Gjykata e Sarandës i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: aleksander sadikaj shpërthim vrasja

TË NGJASHME

Detajet e reja/ 27-vjeçari që u vra sot, i afërt me një të akuzuar për vrasje. Lidhja me "të fortin e Memaliajt", autorët e komanduan eksplozivin nga...

11 Qershor, 2022

"Me Sheikun"/ Nga pasioni i çmendur për kuajt, te shoqëria me dy reperët nga Tirana, ja si e kaluarte kohën viktima e atentatit me tritol (VIDEO)

11 Qershor, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Nata e Shna Ndout në Laç/ Policia masa për 12 dhe 13 qershorin, si do kufizohet lëvizja dhe parkimi i mjeteve

11 Qershor, 2022

Trupi i dekompozuar i një mashkulli në malet e Kolonjës, banorët: U gjet nga barinjtë, nuk kemi dijeni për...

Lorena Kodra | 11 Qershor, 2022

"Po na terrorizojnë mua dhe familjen time", mjeku Edvin Prifti reagon pas akuzave: Në 3 vite përgjim s'kanë gjetur asgjë. Kur unë kërcënohesha me jetë...

11 Qershor, 2022

Plagoset me thikë një 52-vjeçar pranë kishës së Laçit, niset te Trauma (Emri)

11 Qershor, 2022

VIDEO/ Aksident në Laç, motori përplaset me makinën, plagoset rëndë drejtuesi

11 Qershor, 2022

VIDEO/ Shpejtësi deri në 191 km/h, çarë zbuloi makina inteligjente dhe radari automatik në Rrugën e Kombit

11 Qershor, 2022

KATEGORIA VIDEO

Zgjedhja e Presidentit të 4/ Boçi: Procesi i shtyrë me zor nga Rama, antikushtetues. Pse e lamë seancën. Begaj më duket shumë i...

11 Qershor, 2022

VIDEO/ Shpejtësi deri në 191 km/h, çarë zbuloi makina inteligjente dhe radari automatik në Rrugën e Kombit

11 Qershor, 2022

"Me Sheikun"/ Nga pasioni i çmendur për kuajt, te shoqëria me dy reperët nga Tirana, ja si e kaluarte kohën viktima e atentatit me tritol (VIDEO)

11 Qershor, 2022

FOTO+VIDEO/ Vinte nga një familje me prindër të divorcuar, si u bë pronar i një resorti alpin 27-vjeçari që u vra sot. Prej moshës 20-vjeçare...

11 Qershor, 2022

VIDEO/Nga vjedhje në tentativë vrasje, kush ishte 27-vjeçari që u vra në atentat me eksploziv. Ja precedentët

11 Qershor, 2022

VIDEO/ Makina e gjitha në flakë, pamje të reja nga shpërthimi me tritol ku mbeti i vrarë 27-vjeçari

11 Qershor, 2022

Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Punësoi detektivë për të zbuluar tradhtinë e Piques, mediat zbulojnë detaje të reja nga divorci i vitit, Shakira....

11 Qershor, 2022

Kanceri rrezikon t'i marrë jetën 16-vjeçarit/ Nëna mes lotëve: Më ndihmoni, djali tjetër dhe bashkëshorti vdiqën për të njëjtën arsye. Nuk mundem më!

Marjus Merhori | 11 Qershor, 2022

Ronaldo-Mayorga, çështja e përdhunimit që u end me vite të tëra nëpër gjykata, jepet verdikti final

11 Qershor, 2022

"Ushtrisë sonë po i mbarojnë municionet", Ukraina: Thirrje për ndihmë urgjente ushtarake ndërkombëtare

11 Qershor, 2022

Berisha përshëndet deklaratat e kancelarit Scholz: Vuçiç sot, faktor kryesor konfliktualiteti në rajon, luajti rolin e të padituritdhe hipokritit

11 Qershor, 2022

Gazetari i njohur publikon foton e Mbretëreshës Geraldinë 22-vjeçare: Një ndër më të bukurat. Zgjodhi dërgoi një korrier dhe një buqetë të madhe me lule për...

11 Qershor, 2022

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2022 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.